



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____/____/2021

Lënda: Depozitim projekligji

Drejtuar: Z. Gramoz RUÇI
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

K Ë T U

I nderuar Z. Kryetar,

Bazuar në nenin 81 të Kushtetutës dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, ju paraqesim Projekligjin “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10192, DATË 3.12.2009 “PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT, KORRUPSIONIT DHE KRIMEVE TË TJERA NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË”, TË NDRYSHUAR

DEPUTETËT PROPOZUES

[Signature]
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ /2020

**“PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10192, DATË 3.12.2009
“PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR,
TRAFIKIMIT, KORRUPSIONIT DHE KRIMEVE TË TJERA
NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 pas fjalës “pasuritë”, shtohen fjalët me përmbajtjen si më poshtë:
“1...të drejtat reale të garancisë që janë vendosur mbi këto pasuri...”
2. Në pikën 2 pas fjalës “koncesione”, shtohen fjalët me përmbajtjen si më poshtë:
“2...të kredive të marra pranë institucioneve financiare sipas ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
3. Në pikën 3 fjala “konfiskim”, ndryshohet me fjalën “sekuestrim”.
- 4.

Neni 2

Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 2 të nenit 8 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rast se mbi këto pasuri rezultojnë të drejta reale garancie Policia Gjyqësore, detyrimisht informon Prokurorin mbi personat e tretë që i gëzojnë këto të drejta”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në rastet kur rezulton se mbi pasuritë e subjekteve të këtij ligji ekzistojnë të drejta reale garancie, Prokurori dhe/ose Policia Gjyqësore marrin informacion pranë institucioneve financiare.”

Neni 3

Në nenin 12 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 2 të nenit 12, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Vendimi për masën e sekuestrimin i komunikohet menjëherë subjekteve të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji. Në rast se gjatë verifikimeve paraprake sipas

nenit 8 të këtij ligji rezulton se mbi pasuritë e subjekteve të këtij ligji ekzistojnë të drejta reale garancie, vendimi për masën e sekuestrimit i komunikohet edhe personave të tretë që i gëzojnë këto të drejta. ”

2. Fjalja e dytë e pikës 3, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“Kundër këtij vendimi personat e përmendur në nenin 3, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji dhe personat e tretë që gëzojnë të drejta reale garancie, kanë të drejten e ankimit në Gjykatën e Apelit, e cila vendos brenda 15 ditëve nga marrja e akteve.”

3. Në fjalinë e parë të pikës 4, pas fjalës “ligji” shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje “ *personat e tretë që gëzojnë të drejta reale garancie.*”

4. Në pikën 5 pas fjalës “Palëve” shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje “ , *të personave të tretë që gëzojnë të drejta reale garancie.*”

Neni 4

Në nenin 12/a bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 2 të nenit 12/a shtohet pika 2.1 me përmbajtje si më poshtë:

“2.1 Në rastet kur personi i tretë i cili gëzon të drejta reale garancie është në mirëbesim, pasuria nuk mund të konfiskohet përpara se t'i nënshtrohet procedurës së ekzekutimit sipas Kodit të Procedurës Civile”.

Neni 5

Në nenin 12/b bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 të nenit 12/b pas fjalës “palëve” shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje “ *dhe personave të tretë që gëzojnë të drejta reale garancie*”

Neni 6

Në nenin 13 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 1 të nenit 13, pas fjalës “të sekuestruar” shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje:

“, si dhe personat e tretë që gëzojnë të drejta reale garancie mbi këto pasuri.”

2. Në fund të pikës 7 të nenit 13, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rast se mbi këto sende ekzistojnë të drejta reale garancie, sendet përjashtohen nga konfiskimi.”

Neni 7

Në nenin 14 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 4 të nenit 14 pas fjalës “ligji” shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje
“ dhe personave të tretë që gëzojnë të drejta reale garancie”.

Neni 8

Në nenin 18 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 3 të nenit 18 pas fjalës “Prokurorit”, shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje *“dhe personave të tretë që gëzojnë të drejta reale garancie”.*

Neni 9

Në nenin 19 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 1 të nenit 19 shtohet pika 1.1 me përmbajtje si më poshtë:

“1.1 Në rastet kur mbi këto pasuri ekzistojnë të drejta reale garancie, ato nuk mund t'i kalojnë të tretëve, por Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është e detyruar që brenda 15 ditëve nga konstatimi i rrethanave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, ti drejtohet Gjykatës për revokimin e sekuestrimit.

Neni 10

Në nenin 21 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 të nenit 21, pas fjalës “Palëve” shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje “ dhe personave të tretë që gëzojnë të drejta reale garancie”
2. Pas pikës 5, shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Nëse gjatë veprimeve paraprake dhe/ose shqyrtimit gjyqësor rezulton se mbi pasuritë objekt shqyrtimi gjyqësor ekzistojnë të drejta reale garancie, këto pasuri nuk i nënshtrohen konfiskimit.

Neni 11

Në nenin 22 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 e nenit 22, ndryshohet si më poshtë:

“3. Kur gjatë veprimeve paraprake dhe/ose shqyrtimit gjyqësor del se pasuritë e sekuestruara i përkasin personave të tretë ose këta të fundit gëzojnë të drejta reale garancie mbi këto pasuri, Gjykata edhe kryesisht me vendim të arsyetuar i thërret ata për të ndërhyrë në proces.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Në rast se gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se transferimet dhe regjistrimi i pasurisë në emër të të tretëve si dhe vendosja e të drejtave reale të garancisë mbi këto pasuri në favor të të tretëve nuk është bërë nëpërmjet veprimeve juridike fiktive dhe/ose të simuluar, këto pasuri përjashtohen nga konfiskimi.

3. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohen se plotësohen njëkohësisht kushtet sipas nenit 24 të këtij ligji si dhe ligjshmëria e të drejtave reale të garancisë sipas pikës 6 të këtij neni, Gjykata vendos refuzimin e konfiskimit të pasurisë.

Neni 12

Në nenin 24 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 të nenit 24 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d. pasuria nuk rezulton e barrësuar me të drejta reale garancie.”

Neni 13

Në nenin 24/a bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 24/a, shtohen paragrafi i dytë dhe i tretë me këtë përmbajtje:

“Kur gjykata nuk vendos konfiskimin e pasurive të sekuestruara në përputhje me pikën 7 të nenit 22 të këtij ligji, këto pasuri i nënshtrohen procedurës së

ekzekutimit në favor të personit të tretë që gëzon të drejta reale garancie sipas Kodit të Procedurës Civile.

Pasuritë e mbetura pas përfundimit të procedurës së ekzekutimit sipas paragrafit të mësipërm, i nënshtrohen masave parandaluese sipas këtij ligji”.

Neni 14

Në nenin 27 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 të nenit 27 pas togfjalëshit “shuarjes së masës së sekuestrimit” shtohet togfjalëshi “ nga personat e përmendur në nenin 3, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji dhe personat e tretë që gëzojnë të drejta reale garancie”.
2. Në pikën 2 të nenit 27 pas fjalës “pasurisë” shtohet togfjalëshi “ nga personat e përmendur në nenin 3, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji dhe personat e tretë që gëzojnë të drejta reale garancie”

Neni 15

Në nenin 29 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 29 pas pikës 3 shtohet pika 3.1 me këtë përmbajtje:
“3.1. Konsfiskimi nuk çënon të drejtat reale të garancisë të krijuara përpara sekuestrimit sipas këtij ligji. Pasuritë e kaluara në favor të shtetit vazhdojnë të mbeten të barrësuara në favor të personave të tretë që gëzojnë të drejta reale garancie mbi to dhe i nënshtrohen procedurës së ekzekutimit sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

[Shqiptarja.com]